

VENDIM
Nr. 22, datë 29.9.2022

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vitore Tusha	kryetare,
Marsida Xhaferllari	anëtare,
Fiona Papajorgji	anëtare,
Altin Binaj	anëtar,
Sonila Bejtja	anëtare,
Sandër Beci	anëtar,
Ilir Toska	anëtar,
Elsa Toska	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 29.9.2022, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 3 (A) 2022 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: AGIM VODO

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

MITI (MITËR) GJONI

AGJENCIA SHETËTËRORE E KADASTRËS, DREJTORIA RAJONALE LUSHNJË

AVOKATURA E SHETËTIT, ZYRA VENDORE VLORË

OBJEKTI: shfuqizimi i vendimit nr. 00-2021-1795 (131), datë 8.11.2021, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtuësëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: nenet 41, 42, 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Elsa Toska, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkesit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve të subjekteve të interesuara, Miti (Mitër) Gjoni, Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtorisë Rajonale Lushnjë, Avokaturës së Shtetit, Zyrës Vendore Vlorë, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkesi Agim Vodo ka blerë objektin “kinkaleri”, pronë shtetërore e ish-Ndërmarrjes Tregtare Shtetërore, Divjakë, me kontratën e shitjes të datës 23.8.1992.

2. Me vendimin nr. 109, datë 28.12.1994, mbështetur në ligjin nr. 7698, datë 15.4.1993, Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (*KKKP*) të ish-Këshillit të Rrethit Lushnjë ka vendosur njohjen e pronësisë për sipërfaqen 5.500 m² dhe kthimin në natyrë trashëgimtarëve të L. Gj., ndër të cilët është edhe subjekti i interesuar Miti (Mitër) Gjoni, të sipërfaqes së truallit 1.400 m² të ndodhur në Divjakë, Lushnjë. Nga kjo sipërfaqe, në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (*ZVRPP*), Lushnjë është regjistruar sipërfaqja 1.088 m².

3. Me aktin e shitjes së datës 24.11.1995 kërkesi ka blerë nga ish-Këshilli i Rrethit Lushnjë truallin me sipërfaqe 47 m² që zinte objekti “kinkaleri”, sipërfaqe e cila ndodhej brenda sipërfaqes 1.088 m² të njohur dhe të kthyer trashëgimtarëve të L. Gj. Në vitin 1998 kërkesi i është drejtuar

Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë me kërkesëpadi me objekt kundërshtimin e vendimit të KKKP-së, Lushnjë të dhënë në favor të trashëgimtarëve të L. Gj., vetëm për sipërfaqen e tokës 47 m², me pretendimin se ky truall nuk ka qenë plotësisht i lirë, pasi në të ka qenë objekti “kinkaleri”.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me vendimin nr. 572, datë 2.7.1998, ka vendosur pranimin e kërkesës, ndryshimin e vendimit të KKKP-së nr. 109/1994 dhe heqjen e sipërfaqes 47 m² nga kthimi fizik i pronës ish-pronarëve dhe kompensimin e këtyre të fundit.

5. Kundër këtij vendimi, subjekti i interesuar Miti (Mitër) Gjoni ka paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Vlorë, e cila, me vendimin nr. 397, datë 30.9.1998, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 527, datë 2.7.1998 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë, me tjetër trup gjykues.

6. Kundër këtij vendimi është paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë dhe Kolegji Civil i kësaj gjykate, me vendimin nr. 901, datë 23.9.1999, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 397, datë 30.9.1998, të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Apelit Vlorë, me tjetër trup gjykues. Në rigjykim, Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 627, datë 26.11.1999, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 572, datë 2.7.1998, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

7. Pas rekursit të ushtruar nga subjekti i interesuar Miti (Mitër) Gjoni, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 1202, datë 21.11.2000, ka vendosur mospranimin e rekursit si të pabazuar në ligj. Mbi rekursin në interes të ligjit, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 28, datë 30.5.2002, kanë vendosur ndryshimin e vendimit nr. 572, datë 2.7.1998 të Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë, nr. 627, datë 26.11.1999, të Gjykatës së Apelit Vlorë, nr. 1202, datë 21.11.2000 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe rrëzimin e kërkesëpadisë me arsyetimin se vendimi i KKKP-së është i drejtë, pasi objekti “kinkaleri” nuk ka qenë ndërtim i përhershëm, por i përkohshëm, për rrjedhojë trualli nuk konsiderohet i zënë në kuptim të ligjit.

8. Kërkuesi, bazuar në ligjin urbanistik të kohës, ka paraqitur kërkesë në Këshillin e Rregullimit të Territorit Divjakë për leje për shesh ndërtimi dhe ndërtimin e një objekti me 3 kate, miratuar me vendimin nr. 3, datë 23.4.2003. Më pas, me kontratën noteriale nr. 3659 rep., nr. 630 kol., datë 2.10.2003, Bashkia Divjakë, në cilësinë e shitësit, i ka kaluar në pronësi kërkuesit edhe sipërfaqen 21 m² truall, mbi të cilën shtrihej objekti i ndërtuar, e cila i shtohet sipërfaqes 47 m² ku ndodhej më parë objekti “kinkaleri”. Kjo pasuri është regjistruar pranë ZVRPP-së Lushnjë në datën 4.11.2003.

9. Në vijim, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë me padi me objekt detyrimin e subjekteve të interesuara ta njohin pronar mbi sipërfaqen e truallit 68 m², mbështetur në nenin 175, paragrafi 4, të Kodit Civil (KC), pra nëpërmjet një mënyre origjinale të fitimit të pronësisë, atë me bashkim, me pretendimin se ndërtimi trekatësh është bërë në kushtet e mirëbesimit dhe se vlera e ndërtimit është më e madhe se ajo e truallit.

10. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me vendimin nr. 1009, datë 7.12.2004 ka vendosur: *“Pranimin e padisë së paditësit Agim Vodo. Të konstatojë pavlefshmërinë e kontratës së shitblerjes noteriale të datës 2.10.2003, nr. 3659 rep., nr. 630 kol., me palë shitës Bashkia Divjakë, blerës Agim Vodo. Të detyrohen të paditurit të njohin pronar paditësin Agim Vodo për sip. 68 m² truall me nr. pasurie 630/93, zona kadastrale 1492, Divjakë. Të detyrohet paditësi Agim Vodo të paguajë në favor të të paditurve vlerën e truallit në shumën 500.000 lekë...”*

11. Kundër këtij vendimi është bërë ankim nga subjekti i interesuar Miti (Mitër) Gjoni në Gjykatën e Apelit Vlorë, e cila, me vendimin nr. 467, datë 21.10.2005, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 1009, datë 7.12.2004 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në atë gjykatë, me tjetër trup gjykues.

12. Pas rigjykimit të çështjes, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me vendimin nr. 323, datë 28.3.2007, ka vendosur rrëzimin e padisë së kërkuesit për njohjen pronar të sipërfaqes së truallit 68 m². Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Vlorë, e cila, me

vendimin nr. 270, datë 22.9.2008, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 323, datë 28.3.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

13. Mbi rekursin e kërkesit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2011-1188 (271), datë 24.5.2011, ka vendosur: “*Ndryshimin e vendimit nr. 323, datë 28.3.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë dhe vendimit nr. 270, datë 22.9.2008 të Gjykatës së Apelit Vlorë, duke pranuar padinë e paditësit Agim Vodo. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të kontratave të shitjes së truallit datë 24.11.1995 dhe datë 2.10.2003, nr. 3659 Rep, nr. 630 Kol. Detyrimin e të paditurve të njohin pronar paditësin Agim Vodo për sipërfaqen 68 m² truall me nr. pasurie 630/93, zona kadastrale 1492 Divjakë, kundrejt pagimit nga paditësi në favor të të paditurve të vleftës së këtij trualli në shumën 525.000 (pesëqind e njëzet e pesë mijë) lekë.*”, me arsyetimin se bazuar në nenin 175, paragrafi 4, të KC-së, kur me mirëbesim është ngritur një ndërtesë në tokën e huaj dhe vlefte e saj është më e madhe se vlefte e tokës, personi që ka ngritur ndërtesën mund të njihet pronar edhe i tokës, me vendim të gjykatës kompetente.

14. Në zbatim të urdhërimeve të vendimit të mësipërm të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, kërkuesi ka kryer dhe pagesën e plotë trashëgimtarëve të L. Gj, e cila është tërhequr prej tyre, me përjashtim të subjektit të interesuar dhe një prej përfituesve të tjerë nga trashëgimia (e bija e një prej trashëgimtarëve të tjerë).

15. Paralelisht me këto procedura, subjekti i interesuar Miti (Mitër) Gjoni, me pretendimin se është pronar i sipërfaqes së tokës në të cilën është ndërtuar objekti i kërkesit, ka ngritur kërkesëpadi me objekt çregjistrimin e objektit “kinkaleri”, si dhe sipërfaqes nën të prej 47 m² nga regjistrat e pasurive të paluajtshme, kthimin e sendit sipërfaqe e truallit prej 47 m², shpërblimin e dëmit, prishjen e ndërtimit dhe lirim të truallit. Në seancën gjyqësore, subjekti i interesuar Miti (Mitër) Gjoni ka kërkuar shtimin e objektit të padisë, duke kërkuar kthimin e truallit me sipërfaqe 68.8 m².

16. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me vendimin nr. 307 (64-2009-431), datë 16.4.2009, ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë së paraqitur nga subjekti i interesuar Miti (Mitër) Gjoni dhe detyrimin e kërkesit të lirojë e dorëzojë sendin tokë truall me sipërfaqe 68.8 m². Kjo gjykatë ka marrë ekspert gjeodet, i cili në aktin e ekspertimit ka konkluduar se i padituri Agim Vodo ka zënë një pjesë të sipërfaqes 68.8 m² që ndodhet brenda sipërfaqes 1.088 m². Sipas gjykatës, posedimi i të paditurit mbi sendin truall me sipërfaqe 68 m² është i paligjshëm, pasi nuk rrjedh nga pronari mbi bazën e një veprimi juridik sipas ligjit ose të një akti administrativ.

17. Mbi ankimin e kërkesit dhe subjektit të interesuar, Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 624, datë 18.6.2010, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit civil nr. 307, datë 16.4.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me arsyetimin se, bazuar në vendimin unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, kërkuesi konsiderohet posedues i paligjshëm i sipërfaqes së truallit prej 68 m² dhe leja e ndërtimit e dhënë nga Bashkia Divjakë ka qenë absolutisht e pavlefshme.

18. Në vijim të rekursit të ushtruar nga kërkuesi, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2014-2272 (434), datë 4.7.2014, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 624, datë 18.6.2010, të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në po atë gjykatë, me tjetër trup gjykues, duke i lënë si detyrë Gjykatës së Apelit që në rigjykim të hetojë në mënyrë të plotë dhe të gjithanshme pretendimet e kërkesit për njohjen pronar, duke iu referuar akteve dhe dokumenteve të paraqitura në cilësinë e provës, përfshirë edhe vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë me të cilin ai është njohur pronar për sipërfaqen e truallit 68 m², si dhe duke pasur në vëmendje vendimin unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

19. Me kërkesën e subjektit të interesuar, ky vendim është bërë objekt i vendimmarrjes së Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), e cila, me vendimin nr. 27 datë 20.2.2015, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

20. Pas rishqyrtimit të çështjes, Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 99, datë 11.5.2016, duke e gjykuar çështjen në fakt, ka vendosur rrëzimin e padisë, me arsyetimin se trashëgimtarët e L. Gj. e kanë humbur pronësinë mbi sipërfaqen e truallit 68 m² me vendimin përfundimtar nr.

271, datë 24.5.2011 të Gjykatës së Lartë dhe se kërkuksi është pronar i ligjshëm i kësaj sipërfaqe, të cilën e ka fituar në bazë të parashikimit ligjor të nenit 175, paragrafi 4 të KC-së. Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit ka paraqitur rekurs subjekti i interesuar Miti (Mitër) Gjoni.

21. Me vendimin nr. 00-2021-1795 (131), datë 8.11.2021, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur prishjen e vendimit nr. 99, datë 11.5.2016 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 307 (64-2009-431), datë 16.4.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me arsyetimin se të gjitha çështjet të cilat janë trajtuar dhe kanë marrë zgjidhje gjatë procesit gjyqësor të zhvilluar përpara Kolegjeve të Bashkuara janë të detyrueshme për t'u zbatuar në çdo proces tjetër gjyqësor që zhvillohet mes të njëjtave palë.

22. Në datën 4.3.2022, kërkuksi i është drejtuar Gjykatës me kërkesë sipas objektit. Në datën 28.4.2022, Kolegji i Gjykatës, bazuar në nenin 31, pika 3, të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur kalimin e kësaj çështjeje për shqyrtim në Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila në datën 12.5.2022, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh.

23. Në datën 15.9.2022 kërkuksi ka paraqitur në Gjykatë një kopje të kërkesëpadisë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me paditës Bashkinë Divjakë dhe të paditur subjektin e interesuar Miti (Mitër) Gjoni dhe trashëgimtarët e tjerë të L. Gj. me objekt *“Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr. 109, datë 28.12.1994, të KKKP-së të rrethit Lushnjë, për truallin me sipërfaqe 1400 m² ... të ndodhur në Divjakë...”*.

24. Po kështu, në datën 26.8.2022 kërkuksi i është drejtuar me kërkesë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me objekt kundërshtimin e veprimeve të përmbaruesit gjyqësor lidhur me titullin ekzekutiv *“Urdhrit të ekzekutimit të lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë nr. 307, datë 16.4.2009, pasi detyrimi nuk ekziston”*, duke arsyetuar se detyrimi në lidhje me pasurinë e kërkuksit është ekzekutuar.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

25. **Kërkuksi** i është drejtuar Gjykatës, sipas objektit, duke pretenduar shkelje të procesit të rregullt ligjor, pasi janë cenuar:

25.1 *Parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit në gjykim*, pasi Gjykata e Apelit Vlorë nuk i ka komunikuar rekursin e bërë nga subjekti i interesuar Miti (Mitër) Gjoni. Po ashtu, edhe Gjykata e Lartë nuk ka verifikuar nëse ai ka marrë dijeni për rekursin dhe për gjykimin që është zhvilluar në atë gjykatë.

25.2 *Parimi i sigurisë juridike*, pasi Gjykata e Lartë në vendimin objekt kërkesë nuk ka marrë parasysh një vendim gjyqësor të formës së prerë të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë të vitit 2011, që i ka njohur kërkuksit përfundimisht të drejtën e pronës mbi pasurinë objekt konflikti gjyqësor.

25.3 *Standardi i arsyetimit të vendimit*, pasi Gjykata e Lartë ka arsyetuar vetëm mbi përfundimin e Kolegjeve të Bashkuara, por pa u ndalur dhe pa arsyetuar në asnjë pjesë të vendimit në lidhje me të drejtat e kërkuksit që burojnë nga një vendim i formës së prerë së Gjykatës së Lartë.

25.4 *E drejta e pronës*, pasi Gjykata e Lartë e ka zhveshur kërkuksin tërësisht nga pronësia e tij, e fituar me një nga format e parashikuara nga legjislacioni në fuqi dhe mbi bazën e një vendimi gjyqësor të formës së prerë.

26. **Subjektet e interesuara**, Miti (Mitër) Gjoni, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Rajonale Vlorë, Avokatura e Shtetit dhe Zyra Rajonale Lushnjë nuk kanë paraqitur prapësime me shkrim, edhe pse janë njoftuar rregullisht nga Gjykata.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuksit

27. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “I” dhe pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

28. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

29. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor, ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

30. Lidhur me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, individ mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Mjetet ligjore konsiderohen të shteruara kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimet nr. 35, datë 1.11.2021; nr. 33, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Në rastin konkret kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshtëm dhe ka paraqitur para tyre, në substancë, pretendimet e paraqitura në këtë ankim kushtetues, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural. Në këto rrethana, Gjykata çmon se kërkuesi e ka plotësuar kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive, pasi nuk ka mjet tjetër ligjor për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese përveç kërkesës në Gjykatën Kushtetuese.

32. Për sa i përket legjitimitetit *ratione temporis*, Gjykata konstaton se kërkuesi e ka paraqitur ankimin kushtetues individual në datën 4.3.2022, ndërsa vendimi gjyqësor më i fundit, që kundërshtohet prej tij, është i datës 8.11.2021. Për pasojë, kërkesa është paraqitur brenda afatit 4-mujor të përcaktuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

33. Në lidhje me legjitimitetin *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, parimit të sigurisë juridike, standardit të arsytimit të vendimit dhe së drejtës së pronës, pretendime të cilat hyjnë në juridiksionin e Gjykatës, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “F”, të Kushtetutës dhe do të shqyrtohen në vijim në lidhje me bazueshmërinë e tyre në themel.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për pretendimin e cenimit të parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit në gjykim

34. Kërkuesi ka pretenduar se vendimi i Gjykatës së Lartë objekt gjykimi ka cenuar parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, pasi Gjykata e Apelit Vlorë nuk i ka komunikuar rekursin e bërë nga subjekti i interesuar Miti (Mitër) Gjoni. Po ashtu, edhe Gjykata e Lartë nuk ka verifikuar nëse ai ka marrë dijeni për rekursin dhe për gjykimin që është zhvilluar në atë gjykatë.

35. Parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit nënkupton se çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta të paraqesë çështjen e tij dhe se asnjë palë nuk duhet të gëzojë avantazh ndaj palës tjetër, por duhet të përcaktohet një ekuilibër i drejtë mes tyre. E drejta për të marrë pjesë në gjykim nuk duhet konsideruar si një e drejtë formale, ku palëve t’u garantohet thjesht prania fizike gjatë procesit, por, përkundrazi, duhet që legjislacioni procedural, në radhë të parë, dhe më pas gjyqtari gjatë gjykimit t’u japin mundësi të barabarta palëve për të paraqitur argumente dhe prova në mbrojtje të interesave të tyre. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në gjykim, atëherë argumentet e njëres palë do të mbizotëronin mbi argumentet e palës tjetër, për rrjedhojë e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj

kushtetues për të garantuar një proces të rregullt ligjor. Bazuar në këto parime, gjykatës i dalin një sërë detyrash, mes të cilave rëndësi të veçantë merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve apo përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe mundësia e deklarimit të tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që janë të lidhura ngushtë me çështjen që shqyrtohet në gjykatë (*shih vendimet nr. 8, datë 23.2.2021; nr. 28, datë 22.5.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

36. Gjykata në jurisprudencën e saj ka përcaktuar disa standarde kushtetuese, të cilat janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën në mënyrë të tillë që cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerëve. Konkretisht, e drejta për t'u njoftuar për një gjykim dhe pjesëmarrja në të është e lidhur me vendimmarrjen e gjykatës, e cila ndikon drejtpërsëdrejti mbi të drejtat subjektive ose interesat e ligjshme të individit. E drejta për t'u njoftuar për të marrë pjesë në gjykim u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor. Nga ana tjetër, e drejta për të marrë pjesë në gjykim krijon të njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjake në raport me palën kundërshtare (*shih vendimet nr. 8, datë 23.2.2021; nr. 49, datë 22.7.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

37. Gjykata vëren se në rastin në shqyrtim procesi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuesi është vënë në lëvizje nga subjekti i interesuar Miti (Mitër) Gjoni. Referuar akteve të dosjes gjyqësore të administruar për nevojat e këtij gjykimi kushtetues, konstatohet se kërkuesi është njoftuar për rekursin e paraqitur nga subjekti i interesuar Miti (Mitër) Gjoni në datën 10.6.2016, çka provohet me dëftesën e komunikimit të nënshkruar nga vetë kërkuesi në datën 15.6.2016, e cila e ka vënë në dijeni të faktit që subjekti i interesuar Miti (Mitër) Gjoni ka vënë në lëvizje Gjykatën e Lartë me rekurs. Gjithashtu, nga faqja zyrtare e Gjykatës së Lartë rezulton se në datën 22.10.2021 është shpallur lista e çështjeve civile për shqyrtim në dhomë këshillimi në Kolegjin Civil në datën 8.11.2021, ora 9:30.

38. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se kërkuesi ka qenë në dijeni të procesit të gjykimit të iniciuar në Gjykatën e Lartë, pasi atij i është komunikuar rekursi dhe sekretaria gjyqësore e Gjykatës së Lartë ka njoftuar me shpallje datën dhe orën e seancës në dhomë këshillimi, të paktën 15 ditë përpara zhvillimit të saj. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit është haptazi i pabazuar.

B.2 Për pretendimin e cenimit të parimit të sigurisë juridike të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor

39. Kërkuesi ka pretenduar se është cenuar parimi i sigurisë juridike, pasi Gjykata e Lartë në vendimin objekt kërkesë nuk ka marrë parasysh një vendim gjyqësor të formës së prerë të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë të vitit 2011, që i ka njohur atij përfundimisht të drejtën e pronës mbi pasurinë objekt konflikti gjyqësor. Po kështu, ai ka pretenduar se është cenuar standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor, pasi Gjykata e Lartë ka arsyetuar vetëm për përfundimin e Kolegjeve të Bashkuara, por pa u ndalur dhe pa arsyetuar në asnjë pjesë të vendimit në lidhje me të drejtat e kërkuesit që burojnë nga një vendim i formës së prerë së Gjykatës së Lartë.

40. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar vazhdimisht rëndësinë e parimit të sigurisë juridike, si një nga aspektet themelore të shtetit të së drejtës, duke e parë të lidhur me parimin *res judicata*, sipas të cilit vendimi gjyqësor i formës së prerë, që përbën gjë të gjykuar, është shprehje dhe konkretizim i së drejtës mbi marrëdhënien juridike dhe ka qëllim t'i japë jo vetëm qartësi, por edhe siguri kësaj marrëdhënieje. Cenimi i parimit të gjësë së gjykuar do të çonte në cenimin e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetuese e ligjore të garantuara nga neni 42 i Kushtetutës, pra në cenim të vetë sigurisë juridike. Siguria juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit të shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin (*shih vendimet nr. 2, datë 11.2.2021; nr. 50, datë 3.7.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

41. Për sa u përket të drejtave të fituara si element i parimit të sigurisë juridike, Gjykata është shprehur se çdo proces ku vihen në dyshim të drejtat e fituara, nuk mund të konsiderohet se qëndron jashtë nocionit të “procesit të rregullt”, përderisa diskutohet e vendoset lidhur me këto të drejta të fituara. Ky parim është i detyrueshëm të respektohet në të gjitha fazat e një procesi ku pretendohet cenimi i të drejtave të fituara dhe për rrjedhojë parimi i sigurisë juridike (*shih vendimet nr. 11, datë 16.4.2018; nr. 10, datë 13.2.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

42. Në lidhje me standardin e arsytimit, Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë e arsytimit të vendimeve gjyqësore, penale ose civile, si një garanci për procesin ligjor. Në jurisprudencën e saj të vazhdueshme ajo ka theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t’u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet edhe vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (*shih vendimet nr. 6, datë 16.2.2021; nr. 8, datë 28.2.2012; nr. 8, datë 16.3.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

43. Në këtë drejtim, vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë gjithashtu të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Konkluzionet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik (*shih vendimet nr. 19, datë 1.4.2021; nr. 20, datë 13.4.2012; nr. 38, datë 30.12.2010, të Gjykatës Kushtetuese*).

44. Duke iu rikthyer rastit konkret, Gjykata vlerëson të marrë në konsideratë vendimet e Gjykatës së Lartë të cilat kanë disponuar në mënyrë përfundimtare për pasurinë objekt konflikti dhe të drejtën e pronës private të kërkuarit.

45. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, mbi rekursin në interes të ligjit të subjektit të interesuar, me vendimin nr. 28, datë 30.5.2002 kanë konkluduar se objekti “kinkaleri” i blerë nga kërkuari është ndërtim i përkohshëm, ndaj në kuptim të ligjit për kthimin e kompensimin e pronave ish-pronarëve truallit me sipërfaqe 47 m², mbi të cilin ky objekt ishte vendosur, konsiderohej i lirë. Mbi këtë bazë Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë gjetur të ligjshëm vendimin e KKKP-së, Lushnjë për njohjen dhe kthimin në favor të ish-pronarit të truallit mbi të cilin gjendej objekti i kërkuarit, duke rrëzuar padinë e këtij të fundit. Në këtë vendim, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë konstatuar edhe pavlefshmërinë absolute të kontratës së shitjes së truallit nga Bashkia Divjakë në favor të kërkuarit, në rrethanat kur kontrata nuk ka qenë në formën e kërkuar nga ligji, pra me akt noterial. Si përfundim, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë pranuar të drejtën e pronësisë së subjektit të interesuar mbi truallin objekt konflikti sipas vendimit të KKKP-së, Lushnjë.

46. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2011-1188 (271), datë 24.5.2011, duke mbajtur në vëmendje edhe vendimin unifikues nr. 28, datë 30.5.2002, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ka shpallur pavlefshmërinë e kontratës së shitjes me Bashkinë Divjakë, duke vlerësuar se ajo nuk ishte lidhur në përputhje me parashikimet ligjore, por, nga ana tjetër, ka njohur kërkuarin pronar bazuar në nenin 175, paragrafi 4, të KC-së, i cili parashikon se kur me mirëbesim është ngritur një ndërtesë në tokën e huaj dhe vlefëta e saj është më e madhe se vlefëta e tokës, personi që ka ngritur ndërtesën mund të njihet pronar edhe i tokës, me vendim të gjykatës kompetente. Kolegji Civil vijon me arsytimin se fakti që kërkuari nuk ka qenë në dijeni të vendimit të Kolegjeve të Bashkuara e vendos atë në kushtet e mirëbesimit, si dhe bazuar në vlerësimet e ekspertëve, vlera e objektit të ndërtuar e kalon 12 herë vlerën e truallit. Përveç njohjes pronar, Kolegji Civil ka parashikuar edhe të drejtën e dëmshpërblimit të subjektit të interesuar dhe bashkëpronarëve të tjerë, detyrim të cilin kërkuari e ka përmbushur (pavarësisht se

rezulton se kjo shumë nuk është tërhequr nga subjekti i interesuar Miti (Mitër) Gjoni dhe një prej përfituesve të tjerë nga trashëgimia, e bija e një prej trashëgimtarëve të tjerë), dhe në vijim ka regjistruar pronën në ZVRPP-në, Lushnjë.

47. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2021-1795 (131), datë 8.11.2021, ka arritur në përfundimin se vendimi i Kolegjeve të Bashkuara nr. 28, datë 30.5.2002 duhet të kishte përparësi, pasi të gjitha çështjet të cilat janë trajtuar dhe kanë marrë zgjidhje gjatë këtij procesi gjyqësor (*të zhvilluar përpara Kolegjeve të Bashkuara*) janë të detyrueshme për t'u zbatuar në çdo proces tjetër gjyqësor që zhvillohet mes të njëjtave palë. Kolegji Civil ka arritur në përfundimin se subjektit të interesuar i është njohur e drejta e pronësisë dhe për këtë shkak është zgjidhur drejt mosmarrëveshja nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me vendimin nr. 307 (64-2009-431), datë 16.4.2009, i cili e ka zhveshur kërkuesin nga pronësia mbi objektin dhe truallin.

48. Në përmbledhje të sa më lart, Gjykata vëren se midis palëve është krijuar një mosmarrëveshje pronësie, e zgjatur në kohë, tek e cila janë vënë përballë subjekti i shpronësuar për të rivendosur të drejtën e pronësisë sipas ligjit (subjekti i interesuar) dhe individ, i cili bazuar në veprime të administratës shtetërore ka blerë pasuri shtetërore dhe me lejen përkatëse ka investuar, duke ndërtuar pasuri të re (kërkuesi). Midis kërkuesit dhe subjektit të interesuar janë zhvilluar disa procese gjyqësore me objekt të drejtën e pronësisë, të cilat kanë qenë me të njëjtat palë, por me objekte dhe shkaqe të ndryshme ligjore. Kërkuesi dhe subjekti i interesuar Miti (Mitër) Gjoni në këto procese kanë qenë, gjithashtu, në pozita të ndryshme procedurale, si paditës dhe të paditur.

49. Megjithatë, pavarësisht këtij konstatimi, Gjykata vlerëson se edhe pse në rastin konkret nuk ndodhemi në kushtet e kuptimit klasik të *“gjësë së gjykuar”*, meqenëse vendimet kanë palë ndërgjyqëse, objekte dhe shkaqe ligjore të ndryshme, nuk mund të anashkalohet fakti që kërkuesi ndodhet përballë dy vendimeve të Gjykatës së Lartë, të cilat kanë disponuar në mënyrë të ndryshme për të drejtën e tij të pronësisë. Gjykata ka çmuar se parimi i gjësë së gjykuar përfshin jo vetëm urdhërimet e dispozitivit të vendimit gjyqësor, por edhe vërtetimet e fakteve dhe zbatimin e së drejtës, të përcaktuara në pjesën përshkruuese arsyetuese të vendimit, me kusht që të jenë kryer me qëllim dhënien e vendimit gjyqësor dhe t’iu përkasin fakteve ose marrëdhënieve që kanë formuar objektin e gjykimit mbi të cilin gjykata ka dhënë vendimin e saj (*shih vendimet nr. 17, datë 30.3.2021; nr. 24, datë 12.11.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

50. Në lidhje me sigurinë juridike, Gjykata konstaton se Kolegji Civil është shprehur: *“Për sa më lart, dhe referuar akteve të dosjes gjyqësore si dhe vendimit të arsyetuar, rezulton se Gjykata e Apelit Vlorë ka përsëritur shqyrtimin gjyqësor duke administruar vendimin nr. 271, datë 24.5.2011 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, mirëpo në pikëpamje të interpretimit ligjor të mosmarrëveshjes, ky Kolegj vlerëson se gjykata nuk e ka zgjidhur drejtë atë. Në thelb të shkaqeve të ngritura në rekurs, pala paditëse ka pretenduar cenim të parimit të sigurisë juridike, për shkak se vendimi i rekursuar është marrë në kundërshtim me vendimin nr. 28, datë 30.5.2002 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Për këtë arsye, Kolegji vlerëson të shtrojë për diskutim këtë moment të lidhur me dy vendimmarrje të Gjykatës së Lartë, në të cilat janë përfshirë të njëjtat palë si dhe të marrë në analizë faktin nëse mund të konsiderohet se pala e paditur Agim Vodo ka fituar pronësinë mbi objektin (truall dhe ndërtim i ri) sipas njëres prej mënyrave të fitimit të pronësisë që parashikon kodi civil, neni 175 i tij, për shkak të vendimit nr. 271, datë 24.5.2011 të Gjykatës së Lartë?”* (*shih paragrafin 24 të vendimit nr. 00-2021-1795 (131), datë 8.11.2021 të Kolegjit Civil*).

51. Sa më sipër, Gjykata vëren se Gjykata e Lartë në vendimin objekt kundërshtimi ka trajtuar parimin e sigurisë juridike vetëm në drejtim të pretendimeve të ngritura në rekurs nga subjekti i interesuar Miti (Mitër) Gjoni, për shkak se vendimi i rekursuar i Gjykatës së Apelit Vlorë është marrë në kundërshtim me vendimin nr. 28, datë 30.5.2002 të Kolegjeve të Bashkuara. Ndërkohë rezulton se ky parim nuk është analizuar nga Gjykata e Lartë për sa iu përket të drejtave të kërkuesit të fituara me një vendim gjyqësor të formës së prerë.

52. Në këtë vështrim, Gjykata arrin në konkluzionin se cenimi i parimit të sigurisë juridike nga ana e Gjykatës së Lartë ka ardhur edhe si rezultat i një arsyetimi i cili nuk përputhet me faktet e mosmarrëveshjes. Konkretisht, pas arsyetimit të vendimit të Kolegjeve të Bashkuara, Gjykata

vëren se Kolegji Civil nuk ndalet në vlerën dhe analizën e vendimit nr. 00-2011-1188 (271), datë 24.5.2011, i cili është një vendim përfundimtar dhe i formës së prerë i Gjykatës së Lartë, por mjaftohet vetëm me faktin se çështjet e trajtuara nga Kolegjet e Bashkuara janë të detyrueshme për t'u zbatuar në çdo proces tjetër, duke mos arsyetuar mbi faktin se tashmë kërkuesi ndodhet në kushte të ndryshme nga ato të përmendura në vendimin e Kolegjeve të Bashkuara. Kolegji Civil ka anashkaluar mënyrën e fitimit të pronësisë sipas vendimit të Kolegjit Civil të vitit 2011, duke lënë në fuqi një vendim i cili shprehet për një objekt që nuk ekziston. Në pronësi të kërkuetit nuk është i regjistruar objekti "kinkaleri", por një objekt 3-katësh, pronësinë e të cilit kërkuesi e ka fituar me vendim gjyqësor të formës së prerë. Gjykata pranon që kompetenca e saj është e kufizuar për të interpretuar/vlerësuar ligjshmërinë e vendimeve në lidhje me të drejtën e pronës së kërkuetit, pasi kjo është kompetencë e Gjykatës së Lartë. Por kur është rasti që individ (kërkuesi) ka fituar pronësinë me vendim të formës së prerë, i cili aktualisht është në fuqi dhe për të cilin krijohet pritshmëri e ligjshme për pronën në rastin kur vendimi nuk është shfuqizuar, Gjykata ka për detyrë të garantojë zbatimin e standardeve të fuqisë së vendimeve të formës së prerë në aspektin e sigurisë juridike. Për më tepër, në lidhje me cenimin e sigurisë juridike, të krijuar nga vendimet e ndryshme të gjykatave, Gjykata konstaton se edhe institucionet e administratës shtetërore, nëpërmjet sjelljes së tyre, duke pasur parasysh edhe periudhën e gjatë të këtij konflikti, kanë krijuar pritshmëri te subjektet e përfshira, duke e rënduar situatën e pasigurisë juridike.

53. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuetit për cenimin e parimit të sigurisë juridike të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor është i bazuar.

B.3 Për pretendimin e cenimit të së drejtës së pronës

54. Kërkuesi ka pretenduar se i është cenuar edhe e drejta e pronës, pasi Gjykata e Lartë e ka zhveshur atë tërësisht nga pronësia e tij, e fituar me një nga format e parashikuara nga legjislacioni në fuqi dhe mbi bazën e një vendimi gjyqësor të formës së prerë.

55. Kushtetuta, në nenin 41, pikat 1 dhe 2, ka parashikuar se e drejta e pronës është e garantuar dhe ajo fitohet me dhurim, me trashëgimi, me blerje dhe me çdo mënyrë tjetër klasike të parashikuar në KC.

56. Gjykata vëren se pretendimi për cenimin e së drejtës së pronës, është i lidhur ngushtë me cenimin e parimit të sigurisë juridike të kërkuetit, për të cilin ajo më lart konstatoi cenimin në kuptim të mosrespektimit të një vendimi gjyqësor të formës së prerë, i cili kishte vendosur përfundimisht çështjen e pronës së kërkuetit, ndaj dhe në këtë drejtim ajo vlerëson se me të njëjtin arsyetim vendimi objekt kundërshtimi i Gjykatës së Lartë i ka cenuar kërkuetit edhe të drejtën e pronës.

57. Në përfundim, Gjykata vlerëson se kërkesa është e bazuar dhe duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "P" dhe 134, pika 1, shkronja "I", të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.
 2. Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 00-2021-1795 (131), datë 8.11.2021 të Gjykatës së Lartë.
 3. Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 29.9.2022

Shpallur, më 31.10.2022

Kryetare: Vitore Tusha

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Altin Binaj, Elsa Toska, Ilir Toska